



Frasme Qyelles
Qyelles



Arkesider Lucej Jucej
Maida Monopati T'Muf

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1737 / Prot. 11

Vlorë më, 23 . 09 .2023

VENDIM
Nr. 47 datë 29.09.2023

PËR
MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT DERI NË MASËN 20% TË PROGRAMEVE TË
PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË FUSHËN E MËSUESISË


Në mbështetje të nenit 25 pika 7, nenit 38 pika 1, shkronja dh , nenit 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur me shkresën Nr.1342/2 prot, datë 27.09.2023, propozimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, me nr.1342/1 prot datë 22.09.2023, Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane me nr.1341/1, prot datë.22.09.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 29 .09.2023,


VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Zv Rektorit Akademik për miratimin e riorganizimit deri në 20% të programeve të Ciklit të dytë të Studimeve në fushën e Mësuesisë si më poshtë:

I. FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

1. Programi i studimit "Master i Shkencave ne "Mesimdhënie e gjuhes shqipe dhe letersise"
 - Hiqet lënda "Kurs Monografik" me 5 kredite, në grupin e Lëndëve me zgjedhje. Shtohet lënda ALB 512 "Edukimi i medias dhe informacionit" me 5 kredite , në grupin e lëndëve me zgjedhje .
2. Programi i studimit "Master i Shkencave" ne" Edukim".
 - Ulen kreditet e lëndës " STAT 550 "Statistike dhe analizë statistikore"" në grupin e Lëndëve karakterizuese (nga 10 ne 5 kredite).
 - Shtohet lënda " EMI 551 "Edukimi i medias dhe informacionit"" me 5 kredite, në grupin e Lëndëve karakterizuese.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

3. Programi i studimit "Master profesional" në "Mesuesi për CLAB në lëndën Gjuhë angleze"
 - Shtohet lenda EMI.E, "Edukim Mediatik dhe Informacion" me 4 kredite, në grupin e Lëndëve me zgjedhje.
4. Programi i studimit "Master profesional" në "Mesuesi për CLAB në lëndën Gjuhë italiane"
 - Shtohet lenda EMI.I, "Edukim Mediatik dhe Informacion" me 4 kredite, në grupin e Lëndëve me zgjedhje.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE ANTYRORE

1. Programi i studimit "Master profesional" në "Mesuesi AM në Biologji, me profil minor në kimi"
 - Shtohet lenda EMI.500, "Edukim i Medias dhe Informacionit" me 4 kredite, në grupin e Lëndëve me zgjedhje
2. Programi i studimit "Master profesional" në "Mesuesi për Arsimin e Mesëm në lëndën e Informatikës"
 - Shtohet lenda EMI.500, "Edukim i Medias dhe Informacionit" me 4 kredite, në grupin e Lëndëve me zgjedhje
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik si dhe Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Fakultetit të Shkencave Humane.
3. Një kopje këtij vendimi përcillet për dijeni në MAS.

Ky vendim hyn fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

